



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:009854
Datë: 09.12.2024
Numri i dokumentit: 06565375

C-IV-14-5313

Parashtruesi i kërkesës

R M fshati Z, Komuna e Shtimes

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (K.B. “Shtime” në likuidim) Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 9 dhjetor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së ankuesit, R M**
- Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 11 korrik 2014, pranë DHPGJS, ankuesi parashtroj një kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit PRN020-0005 datë 12 qershor 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) lëshuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit (AL), me të cilin ju është refuzuar kërkesa për paga të papaguara për periudhën 22 korrik 2009 gjer me 22 gusht 2010, në shumë prej 1,560.00 (një pesë gjashtë zero) Euro, ndaj K.B. “Shtime” (në likuidim).

Kërkesës, për rishikim, i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 22 nëntor 2024 parashtroj përgjigje.

AKP propozoj që kërkesa, e ankuesi, për rishikimin e Vendimit të AL të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e papabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Me 11 nëntor 2024, gjykata lëshoj për ankuesin vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar ankuesin se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Me rastin e dorëzimit vërejtjes mbi pagesën e taksës, nga fletë kthesa nga ana e personit zyrtar të postës, me 15 nëntor 2024, është shënuar një vërejtje me shënim: "marrësi i vdekur".

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së ankuesit, R M

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK).*

Sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet:*

a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim;

Ne vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh:

Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Gjykata ka tentuar që ankuesit t'ia dorëzojë vërejtjen mbi pagesën e taksave gjyqësore, datë 11 nëntor 2024, por nga ana e zyrtarit të postës është konstatuar se pala ka vdekur.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të LPK.

Shpenzimet gjyqësore

Pasi që procedura është ndërprerë në këtë fazë të procedurës nuk caktohen shpenzime gjyqësore.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar